VENDIM
Nr.202, datë 11.4.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.547, DATË 9.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.547, datë 9.8.2006 të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 3 shtohen nënpikat, si më poshtë vijon:

"- Shërben si organ i specializuar për ministrin përgjegjës për energjinë, për problemet e strategjisë dhe të politikës në këtë fushë;

- Promovon burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe propozon masa për rritjen e shfrytëzimit të energjisë në ciklin energjetik;

- Harton dhe publikon bilancin energjetik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë;

- Monitoron kontratat koncesionare për hidrocentralet.".

2. Në pikën 4, pas fjalëve "…Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Mekanikës dhe Drurit…" shtohen "…dhe Agjencia Kombëtare e Energjisë.".

3. Kudo në vendim fjala "hidroenergji" zëvendësohet me "energji".

4. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

"10/1. Vendimet nr.443, datë 16.7.1998 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Energjisë" dhe nr.310, datë 15.5.2003 "Për miratimin e strukturës së nivelit të pagave të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Energjisë" të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha